



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe 47 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

VENDIM PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR BARAZI GJINORE

Neni 1

1. Themelohet Komiteti për Barazi Gjinore, i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në përbërje prej 5 anëtarëve/eve, dhe atë:

- **Ragip Fetahu**, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV
- **Drita Pajaziti**, anëtare, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV
- **Edona Shabani**, anëtare, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK
- **Fahri Hasani**, anëtar, nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK
- **Gentiana Gashi**, anëtare, përfaqësuese nga jashtë Kuvendit, propozuar nga AAK

2. Zgjedhja e kryesuesit/es të Komitetit sipas këtij vendimi, bëhet me shumicë të votave të anëtarëve të Komitetit.

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komitetit për Barazi Gjinore, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Komiteteve, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Kompensimi i anëtarëve të Komitetit sipas këtij vendimi, për mbledhjet e mbajtura bëhet nga buxheti i Komunës dhe atë në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi.


Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe Ekzekutivi i Komunës.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. prot. 01-020/04-0053366/22
Podujevë, Datë: 30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha